

# NDRYSHIMET NË PROGRAMIN E TALLONËVE USHQIMORE BËJNË TË PËRSHTATSHËM PËR PËRFITIME MË SHUMË IMIGRANTË LIGJORË

## Unë nuk jam nënshtetas amerikan. A mund të marr tallonë ushqimorë?

- Ju mund t'i plotësoni kërkesat tani nëse jeni banor i përhershëm ligjor dhe nëse ju, bashkëshorti juaj ose prindërit tuaj e kanë të dokumentuar që kanë punuar në Shtetet e Bashkuara (zyra e tallonëve ushqimorë do të jetë në gjendje të përcaktojë nëse keni arritur të plotësoni kohën e nevojshme të punës). Njerëzit që kanë ardhur në Shtetet e Bashkuara si refugjatë dhe disa prej kategorive të imigrantëve janë të pranueshëm. Edhe ju mund të jeni i pranueshëm nëse po jetonit ligjërisht në Shtetet e Bashkuara më 22 gusht 1996 **dhe** (1) ishit 65 vjeç në atë kohë (keni lindur më ose para 22 gushtit 1931), **ose** (2) tani po merrni pagesa për paaftësi, **ose** (3) jeni nën moshën 18 vjeç. Gjithashtu mund t'i plotësoni kushtet nëse keni qënë në Shtetet e Bashkuara me një status të kualifikuar për 5 vjet.

## Cilat janë ndryshimet e bëra?

- Më 13 Maj 2002, Presidenti Bush nënshkroi një ligj – “Dekretin e Sigurimit të Ekonomisë Bujqësore dhe Investimit Rural të 2002”, që do të lejojë që më shumë jo-nënshtetas dhe imigrantë ligjorë me të ardhura të pakta të marrin tallonë ushqimorë nëse ata i plotësojnë kërkesat e të ardhurave dhe pasurisë të Programit të Tallonëve Ushqimorë.

## Kur do të fillojë të vihet në zbatim ligji?

- Disa imigrantë ligjorë që preken prej ligjit të 2002-it do të jenë të pranueshëm për të marrë përfitimet e tallonëve ushqimorë që më 1 tetor 2002, por shumica nuk do të jenë të pranueshëm deri në një kohë më të vonshme. Informacioni më poshtë shpjegon më mirë se kur fillon pranueshmëria.

Ligji i 2002-it lejon pranueshmëri për imigrantët ligjorë që i plotësojnë kërkesat e programit DHE që:

- ✓ po marrin përfitime paaftësie [të tilla si SSI ose Medicaid (program asistence mjekësore) që jepet për shkak paaftësie] (pranueshmëria për këtë grup fillon më **1 tetor 2002**);
- ✓ kanë jetuar në Shtetet e Bashkuara për 5 vjet me një status të kualifikuar (pranueshmëria për këtë grup fillon më **1 Prill 2003**); ose
- ✓ janë nën moshën 18 vjeç dhe hynë në Shtetet e Bashkuara mbas 22 gushtit 1996 (pranueshmëria për këtë grup fillon më **1 tetor 2003**).

## Cilët imigrantë janë me një status të kualifikuar?

- Tek imigrantët e kualifikuar futen banorët e përhershëm të ligjshëm (që kanë grin kart), refugjatët, ata që kanë fituar azil, njerëzit që u është shtyrë procesi i dëbimit ose largimit, personat që hyjnë që janë kubanezë dhe haitianë, individët që kanë marrë lirim me kusht nga Shërbimi i Imigracionit dhe Natyralizimit për të paktën një vit, personat që hyjnë me kusht dhe viktimat të caktuara të dhunës shtëpijake.

### **A i ndryshon ligji i ri rregullat për imigrantët që tashmë janë të pranueshëm?**

- Jo. Çdo njeri që ishte i pranueshëm më parë vazhdon të jetë i pranueshëm tani.

### **A e zgjeron pranueshmërinë ligji për jo-nënshtetasit që janë në këtë vend për arsye humanitare?**

- Po. Si rezultat i ligjit të vitit 2002, nuk do të ketë më ndonjë kufizim shtatë-vjeçar për tallonë ushqimorë për refugjatët, azilantët, ameriko-aziatikët dhe personat që hyjnë që janë kubanezë dhe haitianë. Duke filluar nga 1 prilli i vitit 2003, këta jo-nënshtetas do të jenë të pranueshëm, nëse ata kualifikohen për programin e bazuar në të ardhurat dhe pasurinë.

### **A do të vendosë Programi i Tallonëve Ushqimorë nëse kam ndonjë paaftësi?**

- Jo. Ju duhet që të jeni duke marrë përfitime ose asistencë nga ndonjë program, si për shembull Medicaid, për arsye se jeni i verbër ose i paaftë.

### **A mund të marr përfitime për fëmijët e mi nënshtetas, edhe pse nuk jam imigrant i pranueshëm?**

- Po. Ju nuk keni nevojë të paraqisni dokumente për veten tuaj kur aplikoni për fëmijët tuaj ose për personat e tjerë të pranueshëm të familjes suaj. Megjithatë, ju përsëri duhet të paraqisni vërtetim të të ardhurave dhe të pasurisë suaj, në mënyrë që punonjësi të vendosë vlerën e përfitimeve të tallonëve ushqimorë për ta.

### **A do të më pengojë marrja e tallonëve ushqimorë për t'u bërë nënshtetas?**

- Jo. Marrja e tallonëve ushqimorë nuk e bën imigrantin një "barrë publike" – kjo do të thotë që një imigrant në Shtetet e Bashkuara nuk do të dëbohet, nuk do t'i mohohet hyrja në vend, ose nuk do t'i mohohet statusi i përhershëm apo "grin karta" për arsyen se ai ose ajo merr tallonë ushqimorë.

### **Si mund të aplikoj ose të mësoj më shumë?**

- Për të marrë tallonë ushqimorë, duhet të dorëzoni një aplikacion në zyrën lokale të tallonëve ushqimorë, që zakonisht ndodhet pranë zyrës lokale të ndihmës sociale.
- Për më shumë informacion, ju lutem telefononi zyrën tuaj lokale të tallonëve ushqimorë të shënuar në faqet blu të numeratorit telefonik nën "departamentin e shërbimeve sociale" ose "departamentin e ndihmës sociale", ose telefononi numri falas në shkallë kombëtare **1-800-221-5689**.
- Centralistë që flasin spanjisht janë gjithashtu në dispozicion në numrin telefonik falas në shkallë kombëtare.

*Tallonët ushqimorë e bëjnë Amerikën më të fortë*